

Monitorimi i zbatimit të indikatorit 5.c.1 të SDG-së në Kosovë

Përgatitur nga Nerina Guri për Rrjetin e Grave të Kosovës

HYRJE

Sipas Grupit të Specialistëve të Këshillit të Evropës, “Buxhetimi gjinor nënkupton aplikimin e integritimit gjinor përgjatë procesit buxhetor. Ky proces realizohet si vlerësim i buxheteve të bazuar në gjini, duke përfshirë një perspektivë gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për të promovuar barazinë gjinore”.¹

Kjo përmbledhje e politikave ekzaminon progresin e Qeverisë së Kosovës drejt implementimit të Indikatorit 5.c.1 të SDG (Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm) të Kombeve të Bashkuara (KB) mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, i cili indikator përfshin: “përqindjen e shteteve me sisteme për të gjurmuar dhe bërë alokime publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave”. Ky indikator ka për qëllim adaptimin dhe forcimin e politikave dhe legjislacionit për të promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vazhde në të gjitha nivelet. Qëllimi i këtij indikator është t’i mundësojë qeverive për të arritur objektivat e politikave gjinore të tyre, siç janë eliminimi i dhunës me baza gjinore apo rritja e punësimit të grave përmes ndarjes së resurseve të barabarta. Siç theksohet në këtë indikator, “gjatë krijimit të alokimeve publike të monitorueshme, qeveritë angazhohen në nivele më të larta të transparencës dhe llogaridhënies në vendim-marrje buxhetore.”²

Kjo përmbledhje është pjesë e një raporti më të zgjeruar monitorues mbi progresin e bërë nga implementimi i indikatorit 5.c.1 të SDG-së në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë, ndërmarrë nga Rrjeti i Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjinor.³ Kjo përmbledhje ka për qëllim të informojë hartuesit e politikave në lidhje me progresin e bërë dhe të ofrojë sugjerime për zhvillimin e politikave të ardhshme në këtë fushë. Kjo përmbledhje përdor metodologjinë dhe kriteret të vendosura në këtë indikator të SDG-së për të vlerësuar progresin e bërë në 2019.⁴ Kriteret përfshijnë: “(1) *synimin e qeverisë për të adresuar barazinë gjinore duke identifikuar nëse ekzistojnë politika, programe dhe burime / buxhete*; (2) *ekzistencën e mekanizmave për të ndjekur shpërndarjen e resurseve drejt qëllimeve të politikave*; dhe (3) *Ekzistencën e mekanizmave për të publikuar shpërndarjen e resurseve për të rritur llogaridhënien tek gratë*.”⁵ Për secilin nga këto kriteret janë përdorur disa pyetje (nën-indikatorë) për të vlerësuar nëse Kosova i përmbush kërkesat e indikatorit SDG 5.c.1, duke përdorur metodologjinë e krijuar nga UN Women për të monitoruar indikatorin 5.c.1. Tabelat përmbledhin rezultatet.

¹ Këshilli i Evropës (2005), Raporti final i Grupit të Specialistëve në Buxhetimin Gjinor (EG-S-GB), EG-S-GB (2004) RAP FIN; Divizioni i Barazisë, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës, Strasbourg, f. 10, tek: http://www.mpsv.cz/files/clanky/12462/GenderBudgeting-report2005_En.pdf.

² Indikatorit SDG 5.c.1, te: <https://gender-financing.unwomen.org/en/highlights/sustainable-development-goal-indicator-5c1>.

³ Organizatat partnere nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnia dhe Hercegovina, Moldavia, dhe Serbia po ndërmarrin këtë nismë si një iniciativë të përbashkët mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me bashkë-financim nga Sida.

⁴ Indikatorit 5.c.1 i SDG, te: <https://gender-financing.unwomen.org/en/highlights/sustainable-development-goal-indicator-5c1>.

⁵ Po aty.



1. Synimi i qeverisë për të adresuar barazinë gjinore duke identifikuar nëse politikat, programet dhe burimet/buxhetet janë në fuqi

Kriteri i parë është që buxheti i përgjegjshëm gjinor (BPGj) duhet të integrohet në planifikime financiare dhe formulime të buxheteve në nivelin qendror dhe atë lokal. Barazia gjinore është e përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës; më specifikisht Neni 7.2 mbi "Vlerat" thotë se "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore", dhe Neni 24, "Barazia Para Ligjit" thotë se "askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal."⁶ Nene të tjera të Kushtetutës kërkojnë përfaqësim bazuar në "parimet e barazisë gjinore" në përbërjen e Kuvendit të Kosovës⁷, shërbimit civil⁸, gjyqësorit⁹, Këshillit Gjyqësor të Kosovës¹⁰, Prokurorisë së Shtetit¹¹, Këshillit Prokurorial të Kosovës¹², dhe Gkatës Kushtetuese.¹³ Neni 5 i Ligjit për Barazi Gjinore thotë se "përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një mjet i rëndësishëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe alokimin e burimeve".¹⁴ Përdorimi i BPGj përfordhet nga Ministria e Financave në qarkoret vjetore të Buxhetit, duke inkurajuar institucionet të aplikojnë BPGj-në. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë punuar në draftimin e një koncept dokumenti mbi institucionalizimin e BPGj në 2019, dhe drafti pritet të publikohet për diskutim publik në 2020.

BPGj përmendet gjithashtu në Programin e dytë të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planin e Veprimit 2020-2024, të cilët janë draftuar në 2019 bazuar në një analizë të situatës dhe proces këshillues¹⁵. Barazia gjinore është e adresuar përmes disa programeve dhe politikave qeveritare, siç janë: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020, Programin për Reforma në Ekonomi (PRE) 2020-2022, dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, mes të tjerash. Gjatë 2019, ABGj ka dhënë komente drejt integritimit të perspektivës gjinore në Strategjinë për Zhvillim Rajonal 2019-2029, Strategjinë për të Drejtat e Njeriut 2016-2020, Projekt-Kodin e Etikës dhe Programin për Reforma në Ekonomi (PRE) 2020-2022.

Duke pasur parasysh që Kosova nuk përdor buxhetimin programatik, është e vështirë të vlerësohet me saktësi shpenzimet për barazinë gjinore bazuar në buxhete. Raporti Vjetor Financiar 2019 nga Thesari i Kosovës, ashtu si raporte financiare tjera vjetore, përfshijnë informata mbi shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe jo programeve.¹⁶ Për shkak të përdorimit të kategorive ekonomike dhe jo buxhetimit programatik, është e vështirë të vlerësohet nëse resurse të mjaftueshme janë alokuar për implementimin e politikave dhe programeve të përmendura më lart. Po ashtu,

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24.2, 2008, fq. 3 dhe 7, te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

⁷ Po aty, Neni 71.2.

⁸ Po aty, Neni 101.1.

⁹ Po aty, Neni 104.2.

¹⁰ Po aty, Neni 108.2 dhe 108.4.

¹¹ Po aty, Neni 109.4.

¹² Po aty, Neni 110.1 dhe 110.3.

¹³ Po aty, Neni 114.

¹⁴ Ligji 05/L -020 mbi Barazinë Gjinore, te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>.

¹⁵ ABGJ, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, 2020, te: [https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Programi%20i%20Kosoves%20per%20Barazi%20Gjinore%20\(2\).pdf](https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Programi%20i%20Kosoves%20per%20Barazi%20Gjinore%20(2).pdf). Rreth 40 aktorë ishin pjesëmarrës në punëtori dhe 12 institucione ofruan komentet në përmbajtje.

¹⁶ Ministria e Financave, Raporti Vjetor Financiar 2019, 2020, fq. 49-58, te: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1E29A660-3716-465F-A1E8-C99AD78E6318.pdf>.

raportet e ekzekutimit të buxheteve të publikuara nga qeveria, si dhe raportet financiare gjysmë-vjetore dhe vjetore nuk përmbajnë informata të shpenzimeve në lidhje me barazinë gjinore apo politikat tatimore prej një perspektive gjinore. Raportime monitoruese të buxhetit nga një perspektivë gjinore nuk publikohen në mënyrë sistematike. Kështu, është e vështirë të llogaritet përqindja e buxhetit të Kosovës që alokohet dhe shpenzohet drejt avancimit të barazisë gjinore. Nuk ekzistojnë procedura të qarta për ekzekutimin e burimeve të ndara për barazinë gjinore. Prandaj, kur vlerësohet Ligji për Buxhetin nga një perspektivë gjinore, është e vështirë të analizohet se sa nga shpenzimet publike shkojnë për barazi gjinore, apo për përfituesit burra dhe gra, përkatësisht. Në 2019, qeveria alokoi €239,222 për ABGj,¹⁷ edhe pse jo të gjitha shpenzimet kanë shkuar domosdoshmërisht për barazi gjinore.¹⁸ Përpos kodit buxhetor për ABGj, “gjinia” si fjalë nuk përmendet në mënyrë eksplicite në ndonjë kod tjetër buxhetor.

Tabela 1 përfshin shembuj ilustrativë, por jo në tërësi, të linjave buxhetore të institucioneve në lidhje me barazi gjinore në 2019.¹⁹ Linja buxhetore tjera mund të ekzistojnë, por nuk kanë qenë lehtë të identifikueshme brenda fushës së këtij hulumtimi, prandaj vetëm disa shembuj të dukshëm janë prezantuar këtu. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka alokuar para për të mbështetur personat që kanë mbijetuar dhunën seksuale, të kryera gjatë luftës. MPMS alokoi €96,000 për organizata jo-qeveritare (OJQ) që mbështesin të mbijetuarat dhe €20,500 për punën e Komisionit për rishikim të aplikacioneve për subvencione në 2019.²⁰ Për herë të parë, si rezultat i avokimit të organizatave të grave, në 2019, parlamenti aprovoi një kod buxhetor për MPMS në shumën prej €880,000 për strehimore: “Shpenzime bazike për strehimore”. Në total, në 2019, qeveria shpenzoi €324,000 duke i mbështetur nëntë strehimore.²¹

Tabela 1. Kodet buxhetore individuale të identifikuar që kanë kontribuar për barazi gjinore në 2019	
Komisioni për rishikimin e aplikacioneve të të mbijetuarave	€20,500
Pagat e Sekretarisë së Komisionit	€18,540
Katër OJQ që kanë mbështetur të mbijetuarat	€96,000
Pensionet e të mbijetuarave (Kodi i pensioneve për viktimat civile të luftës)	€1,098,319
Mallra dhe Shërbime	€7,600
ABGj	€239,222
Nëntë strehimore që kanë mbështetur personat që kanë vuajtur DhBGj	€324,000

Si përfundim, Kosova ka programe dhe politika të qeverisë që janë të dizajnuara për të adresuar qëllimet e identifikuar mirë drejt barazisë gjinore. Mirëpo, meqenëse Kosova nuk përdor buxhet programatik është e vështirë që të vlerësohet nëse këto programe dhe politika kanë burime të *mjaftueshme* të ndara brenda buxhetit për të përmbushur objektivat e tyre të përgjithshme si dhe qëllimet e tyre për barazi gjinore. Kështu, Kosova përmbush vetëm nën-indikatorin e parë dhe të tretë të këtij kriteri (shih Tabelën 2).

¹⁷ ABGj nuk është në pajtim të prezantohet se e vetmja herë që barazia gjinore është përmendur në Ligjin për Buxhet 2019 ka qenë për linjën buxhetore për ABGj, sepse kjo nuk është shpenzuar domosdoshmërisht për barazi gjinore dhe nuk i shton ndonjë vlerë substanciale analizës. RrGK e ka përfshirë këtë meqenëse bazuar në një analizë tekstuale të dokumentit, është e vetmja herë që fjala “gjinore” është përmendur.

¹⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.06/L – 133: Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2019, 2019, te: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18554>.

¹⁹ Tabela nuk ka për synim që të prezantohet një pasqyrë e plotë e të gjitha shpenzimeve publike, meqenëse kjo ka qenë jashtë metodologjisë së paraparë. ABGj nuk është pajtuar me prezantimin e pjesshëm të pasqyrës së buxheteve të institucioneve publike në lidhje me barazi gjinore. RrGK do të dëshironte të përfshinte një pasqyrë të plotë, por të dhënat e nevojshme për këtë nuk kanë qenë në dispozicion dhe do të kishin kërkuar hulumtim shtesë substancial përtej fushës së kësaj përmbledhje të politikave. RrGK pajtohet që këto informata janë të rëndësishme dhe duhet të hulumtohet më shumë në të ardhmen mbi këtë, si dhe të bëhen publike.

²⁰ Korrespondencë me ABGj, 2020.

²¹ Po aty.

Tabela 2. Kriteri 1 Përmbledhje e Rezultateve²²

A ka programe ose politika të qeverisë që janë të dizajnuara për të adresuar qëllimet e identifikuar mirë të barazisë gjinore?	PO
A kanë këto programe ose politika burime të mjaftueshme të ndara brenda buxhetit për të përmbushur si objektivat e tyre të përgjithshëm, ashtu edhe qëllimet e tyre për barazi gjinore?	JO ²³
A ekzistojnë procedura për të siguruar që këto burime të zbatohen sipas buxhetit?	PO

2. Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike promovon qëllime që lidhen me gjininë ose me përgjegjësi gjinore

Në procesin e miratimit të buxhetit për vitin 2019, qeveria e Kosovës nuk ka dhënë informacione mbi ndikimin e Ligjit për buxhetin në gratë dhe burrat dhe rëndësinë e zbatimit të BPGj. Megjithatë, BPGj është përfshirë në Qarkoret Buxhetore në nivel qendror dhe atë lokal.²⁴ Asnjë debat për çështjet gjinore i ditur nuk ka ndodhur në media apo në parlament gjatë hartimit të buxhetit apo pasi që ishte miratuar buxheti. Nuk ka indikacion se Parlamenti po punon për të përmirësuar raportimin e mediave për integrimin e perspektivës gjinore në buxhet. Rëndësia e BPGj-së u përmend nga Grupi i Grave Parlamentare në parlament vitet e fundit, por kjo nuk është bërë rregullisht ose sistematikisht.²⁵

Objektivat e barazisë gjinore janë përfshirë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2020-2022²⁶, dhe BPGj është përmendur në qarkore buxhetore për organizatat buxhetore në nivel qendror dhe lokal në Kosovë.²⁷ Dokumentet buxhetore megjithatë nuk e kanë të integruar perspektivën gjinore siç duhet dhe shumica e prioritetëve nuk janë të ndjeshme ndaj gjinisë.

Qeveria kërkon që Vlerësimi i Ndikimit Gjinor (VNGj) të ndërmerret, ndër hapat e kërkuara kur adoptohet një ligj apo politikë e re.²⁸ ABGj ka draftuar një manual të VNGj, i cili është dizajnuar që të ndihmojë të gjithë aktorët e përfshirë në fazat e çdo politike apo programi dhe shërben si pikë referimi për të kryer vlerësime të ndikimit të barazisë gjinore të të gjitha politikave, programeve dhe aktiviteteve, duke përfshirë vlerësime *ex-ante*.²⁹ Gjatë 2018-2019, ABGj realizoi rreth 14 trajnime dy ditore dhe 11 sesione orientuese për VNGj, ku janë trajnuar 486 shërbyes civil. Gjatë kësaj kohe, 48 koncept dokumente qeveritare janë vlerësuar për ndikimin e tyre.³⁰ Megjithatë, pavarësisht kërkesave për VNGj dhe rritjes së kapaciteteve, si një praktikë e aprovuar rishtazi, cilësia e VNGj mundet

²² ABGj ka observuar se metodologjia duhet të përfshinte edhe një indikator tjetër shtesë: nëse programet dhe politikat kanë përfshirë indikatorë për barazi gjinore. Këto do ta lehtësonin planifikimin buxhetor më të përshtatshëm.

²³ ABGj nuk pajtohet me këtë përfundim, meqenëse ata theksuan që do të kërkonte një analizë të plotë të shpenzimeve publike. Përdorja e një studimi i tillë do të ishte ideal, siç është thënë më herët, kjo ishte përtej fushës së hulumtimit. Sidoqoftë, RrGK beson se konteksti i përgjithshëm dëshmon përfundimin se burime shtetërore të mjaftueshme nuk janë alokuar për të mbështetur të gjitha programet dhe politikat dhe për të mbërritur objektivat për barazi gjinore. Si shembull për të ilustruar fonde të alokuara të pamjaftueshme: Qendrat për Punë Sociale duhet të ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe menaxhim të rasteve për të mbijetuarat e dhunës në familje. Megjithatë, dëshmi të mjaftueshme tregojnë që ata nuk kanë staf të mjaftueshëm, mes të tjera shpenzimeve, për t'i kryer përgjegjësitë e veta. Ky rast, mes të tjerash, provon që financimi i mjaftueshëm drejt qëllimeve për barazi gjinore nuk është alokuar.

²⁴ Ministria e Financave, Qarkorja Buxhetore 2019/01, 2018, te: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/A92BD305-B3A3-478D-A732-FB6F5EBF8DC1.pdf>.

²⁵ Bota sot, Mars, 2017, te: <https://www.botasot.info/video/669622/grupi-i-grave-deputete-diskuton-per-buxhetimin-gjinor-drejtperdrejt/>.

²⁶ Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022, 2019, fq. 71, te: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/A441527F-9494-4A24-849A-CC7405368027.pdf>.

²⁷ Qarkorja Buxhetore 2020/01, 2019, at: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/E1AAB735-D940-48D1-8465-351A0E705928.pdf>; Qarkorja Buxhetore 2020/02 për Komuna, 2019, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/BBC9BFCD-BD95-4398-B80F-0595D98C12AB.pdf>.

²⁸ Zyra e Kryeministrit, Strategjia për Rregullim më të Mirë 2014-2020: Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ, te: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Rregullim_me_te_Mire_2014_2020_-_ALB.PDF.

²⁹ Agjencia për Barazi Gjinore, Manuali i vlerësimit të ndikimit të Barazisë Gjinore, Prishtinë: 2019, te: <https://abgj.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Gender%20Equality%20Impact%20Assessment%20Manual.pdf>.

³⁰ Korrespondencë me ABGj, 2020.

ndonjëherë të jetë e mangtë dhe jo të gjitha programet dhe politikat kalojnë përmes një analize gjinore *ex-ante*.

Institucionet e Kosovës nuk mbledhin dhe mbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë në mënyrë sistematike për të informuar planifikimin e buxhetit dhe ndarjen e burimeve.³¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me ABGJ, botoi *Gratë dhe Burrat në Kosovë 2014/2015* dhe *Gratë dhe Burrat në Kosovë 2016/2017*.³² Mirëpo, një version më i fundit nuk është në dispozicion. Indeksi i Barazisë Gjinore i Bashkimit Europian (BE) ende nuk është krijuar në Kosovë, edhe pse ABGJ është duke bashkëpunuar me ASK për publikimin e të dhënave në lidhje me disa dimensionet të Indeksit.³³ Platforma statistikore interaktive e ASK siguron të dhëna të ndara sipas gjinisë për disa por jo të gjithë treguesit lidhur me politika të ndryshme.³⁴

Një rishikim i shpejtë i gjashtëdhjetë programeve qeveritare sugjeron që ato rrallë kanë tregues të performancës në lidhje me barazinë gjinore. Të paktët tregues të identifikuar lidheshin me drejtësi³⁵, bujqësi³⁶ dhe zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.³⁷ Për më tepër, nga këto gjashtëdhjetë programe qeveritare të rishikuara, me përjashtim të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit, Qeveria e Kosovës e ka përfshirë "barazinë gjinore" si përparësi në mënyrë eksplicite vetëm një herë të: "ngritja e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe përmirësimit të cilësisë së mbrojtjes sociale, arritjes së barazisë gjinore dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare, me një fokus të veçantë në grupet e cenueshme dhe barazinë gjinore," përmes masës "zvogëlimi i varfërisë dhe përjashtimi shoqëror duke siguruar shërbime dhe përfitime të integruara për burrat dhe gratë në nevojë sociale dhe për grupet e tjera të cenueshme". Programe shtesë adresojnë barazinë gjinore në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Për shembull, dy masa trajtojnë të drejtat e pronës dhe sundimin e ligjit për grupet e marginalizuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.³⁸ Masat 19 dhe 20 në Programin për Reforma në Ekonomi 2020-2022 adresojnë shërbimet e punësimit publik, papunësinë afatgjatë të të rinjve dhe grave, dhe përmirësimin e shërbimeve sociale e fuqizimin e grupeve të marginalizuara.³⁹ Ndërsa Ministria e Financave duhet t'i aprovojë të gjitha shpenzimet e parashikuara në programe, programet qeveritare nuk janë gjithmonë të lidhura drejtpërdrejtë apo qartë me buxhetin e Kosovës; treguesit në programe qeveritare jo domosdoshmërisht korrespondojnë me alokimet e buxhetit.

³¹ ABGJ nuk pajtohet me këtë deklaratë dhe ka observuar që ASK prodhon të dhëna sipas gjinisë, duke përfshirë edhe të dhënat e EUROSTAT-it. ABGJ pajtohet që jo të gjitha institucionet kanë të njëjtën sasi dhe cilësi të të dhënave të prodhuara. Siç mund të vërehet, RrGK nuk kontsaton që institucionet e Kosovës nuk mbledhin të dhëna fare, por që mbledhja e të dhënave nuk bëhet në një mënyrë sistematike dhe nuk përdoret në një mënyrë sistematike për të informuar buxhetin. Kjo është dëshmuar nga puna e RrGK me disa ministri, gjatë të cilës shumë zyrtarë u shprehën që të dhëna të tilla nuk janë të domosdoshme dhe që ata nuk i përdorin për t'i informuar buxhetet e tyre.

³² ASK, "Gratë dhe Burrat në Kosovë 2014/2015", Prishtinë: 2016, marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/2582/women-and-men-ang-2014-2015.pdf>. ASK, "Gratë dhe Burrat në Kosovë 2016/2017", Prishtinë: 2018, marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/4582/women-and-man-2016-2017.pdf>.

³³ Më specifikisht, kanë hasur sfida me pyetorin e BE mbi statistikën e të hyrave dhe kushteve të jetesës (EU-SILC).

³⁴ ASK, ASKDATA, at: <https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askda>.

³⁵ Për shembull: "numri i trajnimeve të specializuara (përfshirë në fusha të specializuara, siç janë krimet ekonomike, konfiskimi, prokurimi publik dhe dhuna me bazë gjinore, veçanërisht ngacmimet seksuale) të mbajtura në Akademinë e Drejtësisë të Kosovës dhe institucione të tjera trajnimi." Sipas ABGJ, kjo përfshin edhe "financimin e Komisionit Qeveritar për Verifikimin e Statusit të të Mbijetuarave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës; financimin e katër OJQ-ve të licencuara për të punuar me kategorinë e të mbijetuarave të dhunës seksuale; financimin e strehimoreve për dhunën në familje; dhe, masa afirmative për regjistrimin e pasurisë së përbashkët.

³⁶ Për shembull: "numri i vendeve të reja të punës në sektorin e bujqësisë: burra / gra" përmes masës "rritja e punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave për gra dhe burra në sektorin e agro-ushqimit dhe shërbimeve në sektorin rural".

³⁷ Për shembull: "numri i vendeve të reja të punës të krijuara për burra dhe gra" përmes dy masave "rritja e mbështetjes për NMVM-ve në marrjen e certifikimit të produktit, përmirësimin e teknologjisë dhe forcimin e zinxhirëve të vlerës" dhe "zhvillimin e masave mbështetëse, masave të zinxhirit të vlerave dhe masave të zhvillimit të grumbullimit për të mbështetur rritjen, eksportin dhe produktivitetin e NVM-ve".

³⁸ Zyra e Kryeministrit, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, Prishtinë: 2016, te: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf.

³⁹ Zyra e Kryeministrit, Programi për Reforma në Ekonomi 2020-2022, Prishtinë: 2020, te: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/A92C6CA3-928C-41F3-9DA1-63E0D8CE5701.pdf>.

Në Kosovë, asnjë raport nuk është publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit këto pesë vitet e fundit që analizon buxhetet nga një perspektivë gjinore. Nuk ka asnjë indikacion që zyra e auditimit ose një organ i ngjashëm në Kosovë ka aftësi dhe njohuri të kryejë analiza gjinore ose të publikojë raporte të tilla. Asnjë raport apo dëgjim i tillë nuk është kryer nga parlamenti se deri në çfarë mase buxheti apo politikat tatimore përmbajnë një perspektivë gjinore.

Tabela 3. Kriteri 2 Përmbledhje e rezultateve	
A parasheh qeveria, në kontekstin e buxhetit, një deklaratë të qartë të qëllimeve të lidhura me barazinë gjinore, të njohura shpesh si deklarata të buxhetit gjinor?	JO
A bën Ministra e Financave lëshimin e qarkoreve ose direktivave që japin udhëzime specifike për ndarjet e buxhetit të përgjegjshëm gjinor?	PO
A janë programet dhe politikat kryesore, të propozuara për përfshirje në buxhet, objekt i një vlerësimi <i>ex-ante</i> të ndikimit gjinor?	PO
A janë statistikave dhe të dhënat e ndara gjinore të përdorura në mënyrë sistematike në programet dhe politikat kryesore që të informojnë vendimet e politikave të lidhura me buxhetin?	JO
A ka ndonjë parakusht për të zbatuar një perspektivë gjinore në kontekstin e përcaktimit të objektivave të performancës në lidhje me buxhetin?	JO
A i nënshtrohen programet dhe politikat kyçe vlerësimit <i>ex-post</i> të ndikimit gjinor?	JO
A i nënshtrohet buxheti si një tërësi një auditimi të pavarur për të vlerësuar shkallën në të cilën promovohen politika të përgjegjshme gjinore?	JO

3. Mekanizma për ndarjen e burimeve publike ekzistojnë për të rritur llogaridhënie

Në Kosovë ekzistojnë informacione minimale në lidhje me BPGj. Ekziston një pjesëmarrje shumë e kufizuar e qytetarëve individualë, OJQ dhe grupeve të tjera të akterëve në proceset buxhetore. Vetëm disa OJQ angazhohen në mbajtjen e qeverisë përgjegjëse për arritjen e qëllimeve të barazisë gjinore, si dhe për sigurimin që financat publike i përgjigjen nevojave të grave dhe burrave. Pjesëmarrja e qytetarëve ishte shumë e ulët në konsultimet publike në nivelin lokal për vitin 2019, duke përmbushur vetëm 54% të standardit minimal që 3% e popullsisë së komunës të marrë pjesë në konsultime publike, sipas Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK).⁴⁰ Gratë përbënin gati gjysmën e qytetarëve pjesëmarrës në konsultimet publike në nivelin lokal (47%).⁴¹ Zyrtarët financiarë, kryetarët dhe drejtorët e divizioneve shumë rrallë konsultohen me mekanizmat lokalë të barazisë gjinore (Zyrtarët për Barazi Gjinore) për shkak të mungesës së vullnetit politik për t'i përfshirë ato në proceset e politikë-bërjes. Kosova nuk përmbush asnjërën nga komponentët e këtij kriteri, siç përmbledh tabela 4.

Tabela 4. Kriteri 3 Përmbledhja e rezultateve	
A është bërë informimi mbi ndarjet e barazisë gjinore i publikuar në një mënyrë të qasshme në faqen e Ministrisë së Financave dhe/ose buletinet zyrtare përkatëse ose njoftimet publike?	JO
Nëse është publikuar, a kanë qenë publike informatat për ndarjet e barazisë gjinore në kohën e duhur?	JO
Nëse është publikuar, a janë bërë publike informacionet mbi ndarjet e barazisë gjinore në një format lehtësisht të kuptueshëm?	JO

Përfundimet

Duke përdorur metodologjinë e UN Women për monitorimin e indikatorit 5.c.1 të SDG, një vend mund të konsiderohet që i përmbush kriteret nëse ai shtet:

⁴⁰ Ministria e Pushtetit Lokal, Raporti i Performancës së Komunave 2019, 2020, fq. 20.

⁴¹ Po aty, fq. 45. gratë përfituese të subvencioneve të punësimit dhe ndërmarrësisë përbënin vetëm 36.3% të përfituesve në 2019, fq. 34; gratë gjithashtu përbënin vetëm 6.4% të këshillave lokalë; dhe regjistrimi i përbashkët i pronës ishte i ulët (12.17% prej totalit të atyre që regjistruan pronën në 2019), fq. 14.

- Përgjigjet me “PO” tek 2 prej 3 pyetjeve në Kriterin 1
- Përgjigjet me “PO” tek 4 prej 7 pyetjeve në Kriterin 2
- Përgjigjet me “PO” tek 2 prej 3 pyetjeve në Kriterin 3

Sipas këtyre kritereve dhe nën-treguesve, në bazë të vlerësimit, mund të arrihet përfundimi që Kosova përmbush vetëm kriterin e parë.

Rekomandimet

Përmbushja e rekomandimeve të mëposhtme do ta përmirësonte zbatimin e këtij indikatori dhe do ta avanconte buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në Kosovë:

- Si pjesë e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike, duke përfshirë dhe Strategjinë 2016-2020 të afiliuar, të konsiderohet ndërrimi i sistemit aktual të buxhetit në buxhetimin programatik, që do ta lehtësonte përdorimin sistematik të BPGj dhe buxhetimin e performancës.⁴²
- Qeveria duhet të përdorë buxhetimin me tregues të performancës në lidhje me barazinë gjinore për sektorë dhe kode të ndryshëm buxhetorë, për të demonstruar më qartësisht progresin.
- Statistikat dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë duhet të krijohen, mirëmbahen dhe përdoren në mënyrë sistematike që të informojnë vendimet e politikave, nga të gjitha organizatat buxhetore në nivel qendror dhe lokal.
- Të gjitha programet dhe politikat kyçe duhet t’i nënshtrohen vlerësimeve *ex-ante* dhe *ex-post* të ndikimit gjinor.
- Të gjitha programet e ardhshme qeveritare duhet ta bëjnë të qartë se me cilat kode buxhetore qeveritare secili aktivitet korrespondon, në mënyrë që ta lehtësojë monitorimin e shpenzimeve drejt barazisë gjinore në këto programme.
- Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa, dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, duhet të bashkëpunojnë për të organizuar të paktën një dëgjim publik mbi përgjegjshmërinë gjinore të buxhetit për të informuar finalizimin e tij. Ata duhet të organizojnë dëgjime publike dhe të publikojnë raporte periodike se sa janë buxheti dhe politikat tatimore të përgjegjshme nga aspekti gjinor. Të gjitha këto informata duhet të bëhen të qasshme për publikun.
- Ministria e Financave në bashkëpunim të ngushtë me ABGj duhet të draftojë dhe të sigurojë Deklaratën e Buxhetit Gjinor për çdo Ligj të Buxhetit të propozuar dhe adaptuar çdo vit.
- Zyra Kombëtare e Auditimit duhet ta analizojë buxhetin prej një perspektive gjinore të paktën një herë në pesë vjet, por idealisht çdo vit, duke i bërë këto raporte të qasshme për publikun.
- Informacioni buxhetor duhet të jetë më i qasshëm në faqen e Ministrisë së Financave, në kohë dhe në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme, duke përfshirë informacion në lidhje me alokimet dhe shpenzimet për barazi gjinore.

⁴² ABGj nuk pajtohet me këtë rekomandim. Sipas opinionit të tyre, institucionet duhet të kryejnë analiza gjinore dhe të mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë për t’u përdorur për të t’i informuar aktivitetet dhe indikatorët. Më pas, këto duhet të përdoren për të informuar alokimet buxhetore dhe për të monitoruar progresin në zbatim. ABGj nuk beson që një ndryshim në sistem është i nevojshëm dhe që integrimi i perspektivës gjinore në planifikim dhe bërje të politikave mjafton. RrGK beson që buxheti programatik do të lehtësonte alokimin më të qartë dhe monitorimin e fondeve, sidomos sepse nuk do ta linte këtë të vullneti politik i zyrtarëve, por do të ishte obligativ dhe sistematik për të gjitha organizatat buxhetore për ta përfshirë qartë në buxhetet e tyre, sipas LBGj. Për më tepër, ky rekomandim lidhet me “Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) të Kosovës 2016-2020” të Ministrisë së Financave, e cila po ashtu e ka pranuar që “një problem tjetër kryesor në buxhetim është që planifikimi i buxhetit nga OB [organizatat buxhetore] ende bëhet në bazë të klasifikimit ekonomik dhe administrativ dhe jo sipas programeve / politikave. Kjo e bën buxhetin më pak fleksibil dhe atij i mungojnë informatat mbi indikatorët e performancës” (2016, fq. 27, te: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4C3C68A9-9F6E-480D-AC02-6B34C397A0EA.pdf>).

- Komunat po ashtu duhet të ofrojnë informata me kohë mbi ndarjet buxhetore dhe shpenzimet për barazi gjinore.
- Qeveria duhet t'i bëjë publike informatat mbi ndarjet e barazisë gjinore në një format lehtësisht të kuptueshëm.